

AKT-THEMELIMI I SHOQËRISË

“Audit & Tax Consulting- ATC” SHPK

Sot, më datë 17/07/2024 mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në legjislacionin shqiptar në fuqi personat e mëposhtëm:

1. Z.Ilia Çeçe me numër personal G70903092T lindur më 03/09/1967, ne Korçë dhe banues në Tiranë, Shqipëri.

e cila me cilësinë e "Ortakut Themelues", redaktoi këtë akt themelimi, nëpërmjet të cilit ajo deklaroi se me vullnet të lirë të plotë e të sigurtë, dhe inisiativën e lirë private, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi, në ligjin 9901 datë 4.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", në ligjin 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", në Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor.

**Vendosi të themelojë shoqërinë tregtare, me përgjegjësi të kufizuar, me emërtimin
Audit & Tax Consulting- ATC shpk**

Neni 1

Emërtimi, Selia dhe afati i Shoqërisë

Të themelojë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar, për të zhvilluar veprimtari private. Shoqëria është person juridik shqiptar, veprimtaria e të cilës rregullohet nga kjo kontratë, Statuti i saj dhe Legjislacioni në fuqi.

Neni 2

Shoqëria do të emërtohet **Audit & Tax Consulting- ATC shpk**.

Neni 3

Shoqëria do të ketë Selinë e saj në Adresën: **Rruga Marko Boçari, Nd. 2, H.6, Ap. 8, Njësia Nr 5, Zona Kadastrale 1019, Tiranë.**

Neni 4

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj me afat të pakufizuar. Ky afat mund të zgjatet ose të shkurtet me vendim të Ortakut të Vetëm.

Shoqëria **Audit & Tax Consulting- ATC shpk** gëzon statusin e personit juridik shqiptar nga momenti i regjistrimit si e tillë në regjistrin e QKB-së.

Neni 5

Shoqëria Audit & Tax Consulting- ATC shpk do të ketë si objekt:

- Auditues Ligjor (Ekspert Kontabël i Autorizuar):
- Kryerja e angazhimeve që përmbajnë misione të kontrollit ligjor të llogarive, menaxhim i risqeve të informacionit, shërbime të tjera të sigurisë, kur ato janë në pajtim me natyrën e profesionit dhe me kërkesat e legjislacionit në fuqi, të cilat kërkohen nga entitetet ndryshme publike dhe private.
- Vlerësime të pasurive të luajtshme, të paluajtshme, aktive të tjera materiale dhe jomateriale;
- Shërbime Kontabiliteti dhe të lidhura;
- Konsulencë ekonomike, financiare dhe fiskale për shoqëritë tregtare, personat fizike, individë dhe organizata të tjera
- Shërbime ristrukturimi dhe operacione të vecanta të shoqërive tregtare, lidhur me ndarjen, bashkimin, përthithjen, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit dhe likuidimin;
- Përgatitje plan biznesi, buxhetime dhe analiza financiare, studime tregu etj.
- Shoqëria kryen çdo lloj aktiviteti që bëjnë pjesë në objektin e saj, që lidhet me të dhe që e mbështet atë.
- Shoqëria do të kryejë veprimtarinë e saj në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm Shqiptar.

Neni 6

Selia e shoqërisë mund të transferohet.

Neni 7

Kur shoqëria pushon veprimtarinë e saj, pasi shlyen të gjitha detyrimet që ka, pjesën e mbetur të kapitalit dhe të të ardhurave i përfitojnë ortakët e saj.

Ortaku themelues përballon humbjet e shoqërisë deri në kufirin e vlerës së tij të derdhur në formimin e kapitalit themeltar. Kapitali bazë mund të rritet nga fitimi në natyrë, ose kontribute të ortakut/ve të shoqërisë.

Kapitali themeltar për fillimin e aktivitetit të shoqërisë është në shumën 100,000 lekë, që i takon ortakut themelues ne 1 (një) pjesë. **Z. Ilia Çeçe është mbajtës i një kuote prej 100,000 lekë, e cila përfaqëson 100% të kapitalit.**

Fitimet që do të rezultojnë pas miratimit të bilancit vjetor nga Ortaku i Vetëm e pas zbritjes së taksave do të ndahen si vijon:

- Rezerva ligjore 5% e fitimit neto pas zbritjes së tatimit mbi fitimin.
 - Divident diferenca pas zbritjes së tatimit mbi dividendin
- 

Neni 8

Shoqëria mund të hyjë në veprimtari të përbashkëta me shoqëri të tjera shqiptare ose të huaja, apo me persona fizik edhe kur ato nuk kanë objekt aktiviteti atë të shoqërisë.

Neni 9

Veprimtaria e shoqërisë mund të ushtrohet duke krijuar filiale ose përfaqësi brenda dhe jashtë vendit, në konformitet me ligjin shqiptar ose të huaj.

Të drejtat dhe detyrat e Ortakut:

Neni 10

Ortaku ka këto të drejta kryesore:

- Administrimin e veprimtarisë në përputhje me kontratën dhe statutin.
- Pjesëmarrjen në rezultatet e çdo forme dhe sasi të veprimtarisë së shoqërisë e parashikuar në kontratën e themelimit dhe statutin e saj.
- Paraqitjen e propozimeve dhe shqyrtimin e tyre nga Mbledhja e Asamblesë dhe Organet e tjera të shoqërisë.
- Të heqë dore nga shoqëria, heqja dore nga shoqëria nuk i liron ortakët nga detyrimet financiare të marra më parë ndaj shoqërisë.
- Të marrë pjesë në organet e shoqërisë që janë ose mund të krijohen nëpërmjet përfaqësuesit të tij.
- Të emërojë dhe të shkarkojë përfaqësuesit e saj, punonjësit, ekspertin kontabël dhe likuidatorët.

Ortaku ka këto detyrime kryesore:

- Të depozitojë kuotën e tij dhe kuotën suplementare në përputhje me kontratën dhe statutin.
- Të marrë pjesë në administrimin e shoqërisë nëpërmjet organeve të krijuara nga vetë ai.
- T'i japë shoqërisë të dhënat e domosdoshme për perpunimin e çdo objekti të veçantë lidhur me veprimtarinë e saj.
- Të kryejë detyrat për realizimin e objektivave dhe të funksioneve të shoqërisë.
- Ka detyrimin nëse heq dorë nga shoqëria ti njoftojnë vendimin e tij asamblesë 6 muaj përpara dhe duke çeduar të drejtën e zgjedhjes sipas nenit .
- Ti japë shoqërisë informatat e nevojshme që kanë të bëjnë me ecurinë e veprimtarisë së saj.
- Të kryejë shërbimet e nevojshme për arritjen e objektivave të shoqërisë dhe realizimin e funksioneve të saj.

Administrimi

Organi vendimor i shoqërisë është Ortaku i Vetëm

Sipas rëndësisë së vendimeve mbledhja e Asamblesë mund të jetë: Asambleja e zakonshme dhe Asambleja e jashtëzakonshme.



Neni 12

Administratori

Veprimtaria operative e shoqërisë drejtohet nga Administratori i saj i Përgjithshëm. Ne shoqërinë **Audit & Tax Consulting- ATC shpk**. Administrator i shoqërisë do të jetë: Z. Ilia Çeçe, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal G70903092T, lindur më 03/09/1967 në Korçë, i cili në të njëjtën kohë ka edhe funksionin e përfaqësimit të shoqërisë me të tretët në gjithë veprimtarinë e tij. Administratori emërohet për një kohëzgjatje prej 5 (pesë) vjetësh financiare me përjashtim të rasteve të dorëheqjes ose shkarkimit të parakohshëm. Administratori ka të gjitha kompetencat për të kryer te gjitha veprimet me interes të shoqërisë dhe në emër të saj nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e veprimtarisë së shoqërisë me përjashtim të atyre kompetencave që ligji nuk i njeh. Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë apo të tretëve për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit apo për faj të tij gjatë administrimit të shoqërisë.

Mbyllja e Shoqërisë:

Neni 13

Veprimtaria e shoqërisë pushon me propozimin e bërë nga ortaku, kur gjatë dy vjetëve nuk rezulton rentabël si dhe të gjitha rastet që parashikohen në dokumentet e krijimit të shoqërisë (kontrata).

Shoqëria shpërndahet në formë riorganizimi ose likujdimi.

Likujdimi i Shoqërisë:

Neni 14

Ortaku i vetëm emëron likujdatorin, dhe shoqëria i jep fund veprimtarisë së saj në castin e miratimit të këtij bilanci të likujdimit. Komisioni i Likujdimit përbëhet nga një ose tre antarë. Pasuritë që janë vënë në dispozicion të shoqërisë me të drejtë shfrytëzimi, shiten në vartësi të shkallës së konsumit të tyre. Mjetet financiare të fituara si rezultat i veprimtarisë së shoqërisë e të fililave të saj dhe fondet financiare ndahen ndërmjet ortakëve në përpjestim me kuotat e vëna, pasi të jenë bërë pagesat për kreditorët.

Neni 15

Pushimi i Veprimtarisë së një filiali të Shoqërisë:

Kur pushon veprimtaria e një filiali, për efekte të riorganizimit të tij, afatet e pushimit caktohen nga Ortaku/Asambleja e Ortakëve.

Likujdimi i filialeve bëhet njëlloj si për shoqërinë.

Mjetet financiare të fituara si rezultat i veprimtarisë së filialit të likujduar dhe fondet e tij financiare vihen në dispozicion të shoqërisë pasi tu jenë bërë pagesat likujdatorëve.

Dispozita të hollësishme mbi organizimin e kësaj shoqërie përcaktohen në statutin e saj.

ORTAKU I VETËM

ILIA ÇEÇE

